




Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparografi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparografi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korruptionit, me datë 05.07.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M



- I. Mbylljet rasti APK-DPKI-06-40/24, për zyrtarin e lartë z. Fazli Shala, Drejtor Ekzekutiv i Spitalit të Përgjithshëm në Pejë, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korruptionit.

A r s y e t i m

I. Agjencia për Parandalimin e Korruptionit (në vijim: Agjencia) ka filluar trajtimin e këtij rasti pas pranimit të një denoncimi nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet në kërkesë (citojmë):

[...] si rezultat i Vendimeve të Drejtorit Ekzekutiv Dr. Fazli Shala. Spitali i Përgjithshëm Pejë gjatë vitit 2022 dhe 2023 ka hapur disa konkurse publik për rekrutim të Infermiereve të Përgjithshëm, Teknikëve Laborant, Mami etj., me ç'rast Drejtori Ekzekutiv cakton Komisionin përzgjedhës në përbërje prej 5 anëtarëve dhe njëra nga këta anëtarë të komisionit gjithmonë në të gjitha komisionet është caktuar Infermierja Adelina. Sh.- bashkëshortja e Ardi. Sh. (kushërit të afërt të drejtorit ekzekutiv) dhe këtu lind dyshimi se caktimi i saj në komisionet përzgjedhëse për rekrutim të infermiereve mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së saj si pjese e atyre komisioneve të cilat janë shoqëruar me shume ankesa pas përzgjedhjes se kandidateve te caktuar”.

Konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Më pas, me qëllim të sqarimit të kësaj situate është kontaktuar zyrtari i lartë në fjalë, me ç'rast i njëjti është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit si dhe me informatat që posedon Agjencia lidhur me këtë rast. Zyrtari i lartë ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e tij lidhur me rastin në fjalë, ndërsa sa i përket lidhjes familjare me Ardi. Sh., ai ka theksuar se, ata



jetojnë në të njëjtin fshat dhe gjithashtu kanë të njëjtin mbiemër, por nuk janë në lidhje familjare të afërt me të”.

Fillimisht, për të vërtetuar afërsinë eventuale familjare në mes të Drejtorit Ekzekutiv z. Fazli Shala dhe zyrtarit Ardian. Sh. të pretenduar nga raportuesi i rastit, Agjencia ka dërguar kërkesë më shkrim në Agjencinë për Regjistrimin Civil (ARC), dhe nga përgjigja e ARC-së (*shkresa zyrtare nr.: 02/582*) rezulton se (*citojmë nga shkresa e tyre*): “[...]. *Bazuar në të dhënrat nga Regjistri Civil, ku si bazë për verifikim kemi përdorur trungun familjarë të të dy shtetasve, Fazli Shala me numër personal [...], dhe Ardian Sh., me numër personal [...], ju informojmë se nuk kemi gjetur ndonjë lidhje familjare mes tyre’.*

Duke qenë se ARC si institucion kompetent i gjendjes civile, përkatësisht i verifikimit dhe vërtetimit të afërsisë familjare mes shtetasve të Republikës së Kosovës, ka konstatuar se, *nuk ka gjetur ndonjë lidhje familjare mes zyrtarit të lartë z. Fazli Shala dhe z. Ardian Sh.*, atëherë rrjedhimisht përashtohet afërsia familjare e pretenduar nga raportuesi i rastit edhe në mes të z. Fazli Shala dhe bashkëshortes së Ardian Sh.

Kështu, me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që:

“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund te ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”.

Ndërsa me dispozitën e nenit 17 [*Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit*], parografi 1 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përcaktuar se:

“Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdekclarimin paraprak, rast për rast të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiq nga kjo vendimmarrje.”

Lidhur me nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se:

“Interesi privat i personit zyrtar - nënkuption çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste”,

si dhe me nënparagrin 1.6 të këtij nenin me të cilin është përkufizuar se:

“person i afërm me zyrtarin është bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dyte si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesit privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. [...].”

Ndërsa dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e definon nocionin vendimmarrje si:

“çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe

përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik."

Pra, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me procesin e vendimmarrjes apo çasteve paraprake të vendimmarrjes, nën kushtet e ekzistencës së interesit privat të zyrtarit apo të personave të afërm me të në një çështje të caktuar. Për tu konstatuar konflikti i interesit në një çështje të caktuar, duhet të plotësohen kushtet thelbësore (kumulative) të tij, siç është vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes si dhe *interesi privat i zyrtarit ose i personave të afërm me zyrtarin*.

Sikurse u konstatua mësipër, në rastin konkret nuk është vërtetuar afërsia familjare në kuptim të dispozitave përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, prandaj, Agjencia konstaton se në rastet kur nuk plotësohet (përbushet) njëri nga kushtet e domosdoshme kumulative të konfliktit të interesit, siç është *interesi privat i zyrtarit ose i personave të afërm me zyrtarin* në rastin konkret, përjashtohet konflikti i interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: "Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimitarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.", si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: "Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative."

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./zngj. (zyrtarit përgjegjës)

YLLI BULESHKAJ
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit